

THIRRJE PER MOBILITET STAZHI PROFESIONAL - 2017

1. Thirrja per kandidatura eshte e disponueshme ne adresen e AUF –it per Evropen qendrore dhe lindore : <https://www.auf.org/bureau/bureau-europe-centrale-et-orientale/>

2. Kalendari

13 dhjetor 2016	-	Hapja e thirrjes per aplikim
15 shkurt 2017	-	Mbyllja e thirrjes
20 – 24 shkurt 2017	-	Intervistat me kandidatet
6 mars 2017	-	Shpallja e rezultateve
1 prill – 31 dhjetor 2017	-	Realizimi i mobliteteve te stazhit professional

3. Kushtet per kandidaturat

Kandidati duhet:

- Te jete frankofon (minimalisht niveli B1);
- Te jete i regjistruar ne nje universitet anetar i AUF gjate vitit 2016-2017 ;

Studentet e viti te pare bachelor nuk kane te drejte te aplikojne.

Studentet e vitit te fundit te ciklit universitar duhet ta kryejne stazhin profesional para fundit te vitit 2016-2017 ne menyre qe te gezojne statusin e studentit gjate kesaj kohe.

- Te zgjedhe nje strukture pritese jashte vendit qe ka si gjuhe pune frengjishten dhe te pranohet nga kjo e fundit ;

Struktura pritese mund te jete nje organizate publike ose private, fitimprurese ose jofitimprurese, aktive ne tregun e punes ose ne fushat e arsimit, formimit dhe atyre socio-edukative.

Dosja e kandidatit depozitohet online. Formulari i kerkeses per mobilitetin e stazhit profesional do te jete i arritshem ne adresen : <https://formulaire.auf.org> pas dates 10 janar 2017.

Te gjitha dokumentat duhet te jene te hartuara ose perkthyer ne frengjisht. Dosjet me mangesi ose qe nuk jane konform kriterëve nuk do te merren parasysh.

Asnje dokument shtese nuk do te pranohet pas dates se mbylljes se thirrjes.

Asnje dokument nuk do te pranohet pas depozitimit te dosjes online edhe pse thirrja per aplikim do te jete akoma e hapur. Kandidati nuk mund te depozitoje me shume se nje dosje.

4. Dokumentat e nevojshem per aplikim

Per te qene e plote dhe e vlefshme, dosja duhet te permbaje dokumentat e meposhtem (qe do t'i bashkengjiten formularit, ne format PDF) :

1. Kopje e nje mjetei identifikimi ;
2. Leter motivimi ;
3. Curriculum vitae e perditesuar ;
4. Liste notash per te gjitha vitet akademike dhe semestrat e perfunduar, te perkthyer dhe te certifikuara nga noteri ose institucioni i origjines ;
5. Vertetim studenti e vlefshme per vitin akademik 2016-2017 ;
6. Vertetim marreveshjeje i institucionit te origjines (Learning agreement), firmosur dhe vulosur nga shefi i departamentit dhe dekani (model i percaktuar nga AUF);
7. Vertetim konfirmues nga struktura pritese qe percakton se gjuha e punes eshte frengjishtja;
8. Dokumenta te tjera: vertetim i kompetencave gjuhesore ne frengjisht (nese ka);
9. Vertetim bashkefinansimi (nese ka ne rastin kur struktura pritese e percakton ne vertetimin konfirmues qe ajo ofron nje bashkefinansim financiar ose ne natyre).

5. Fushat ku mund te aplikohet :

- Menaxhim territori D103
- Mjedis D120
- Gjeologji D124
- Hidrologji D127
- Telekomunikacion D145
- Arkitekture D106
- Inxhinieri D122